



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 14, datë 30.12.2021

**PËR**

**MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN: “ZGJERIM I RRJETIT TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE TË OPERATORIT VODAFONE ALBANIA, NËPËRMJET SHTIMIT TË ANTENAVE PËR 14 STACIONE BAZË TË EMËRTUARA:**

**1. FAFA RESORT 1314, 2. ELBASAN SOUTH WEST 1350, 3. KUKËS EAST 1355, 4. HAMALLAJ 309, 5. KUKËS 2, 1398, 6. CASA ITALIA 1399, 7. 1313 GOLEMI, 8. 1349 THUMANË, 9. 1351 KORÇË SOUTH WEST, 10. TOPOJA 1233, 11. DURRËS NORTH 2 1311, 12. TËRBUFI 1321, 13. HOTEL MONARC 1344, 14. FARI 1348”, ME VENDNDODHJE BASHKITË ELBASAN, DURRËS, TIRANË, KRUIË, KORÇË, FIER DHE KUKËS**

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, VKM-së Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe VKM-së Nr.519, datë 20.09.2017 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të shoqërisë “Vodafone Albania” sh.a, Këshilli Kombëtar i Territorit,

**VENDOSI:**

1. Miratimin e Lejes së Ndërtimit për objektin: “Zgjerim i rrjetit të komunikimeve elektronike të Operatorit Vodafone Albania, nëpërmjet shtimit të antenave për 14 stacione bazë të emërtuara: 1. Fafa Resort 1314, 2. Elbasan South West 1350, 3. Kukës East 1355, 4. Hamallaj 309, 5. Kukës 2, 1398, 6. Casa Italia 1399, 7. 1313 Golemi, 8. 1349 Thumanë, 9. 1351 Korçë South West, 10. Topoja 1233, 11. Durrës North 2 1311, 12. Tërbufi 1321, 13. Hotel Monarc 1344, 14. Fari 1348”, me vendndodhje Bashkitë Elbasan, Durrës, Tiranë, Krujë, Korçë, Fier dhe Kukës, me zhvillues shoqërinë “Vodafone Albania” sh.a.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhet si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Dokumentet i Lejes së Ndërtimit i jepen subjektit zhvillues veçmas për secilin prej 18 stacioneve bazë, vetëm pas:
  - 3.1 Për stacionin “**Fafa Resort 1314**”:
    - pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Kavajë.
  - 3.2 Për stacionin “**Elbasan South West 1350**”:

- lëshimit të aktit të miratimit për veprimtarinë me burime të rrezatimit jojonizuese;
- pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Elbasan.

3.3 Për stacionin **“Kukës East 1355”**:

- pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Kukës.

3.4 Për stacionin **“Hamallaj 309”**:

- miratimit të akteve përkatëse sipas legjislacionit të posaçëm për trashëgiminë kulturore;
- lëshimit të aktit të miratimit për veprimtarinë me burime të rrezatimit jojonizuese;
- miratimit të vendimit të VNM-së (Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis) përkatëse;
- pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Durrës.

3.5 Për stacionin **“Kukës 2, 1398”**:

- miratimit të akteve përkatëse sipas legjislacionit të posaçëm për trashëgiminë kulturore;
- lëshimit të aktit të miratimit për veprimtarinë me burime të rrezatimit jojonizuese;
- pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Kukës.

3.6 Për stacionin **“Casa Italia 1399”**:

- miratimit të akteve përkatëse sipas legjislacionit të posaçëm për trashëgiminë kulturore;
- pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Tiranë.

3.7 Për stacionin **“1313 Golemi”**:

- pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Kavajë.

3.8 Për stacionin **“1349 Thumanë”**:

- lëshimit të aktit të miratimit për veprimtarinë me burime të rrezatimit jojonizuese;
- pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Krujë.

3.9 Për stacionin **“1351 Korçë South West”**:

- lëshimit të aktit të miratimit për veprimtarinë me burime të rrezatimit jojonizuese;
- pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Korçë.

3.10 Për stacionin **“Topoja 1233”**:

- pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Fier.

3.11 Për stacionin **“Durrës North 2 1311”**:

- pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Durrës.

3.12 Për stacionin **“Tërbufi 1321”**:

- pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Divjakë.

3.13 Për stacionin **“Hotel Monarc 1344”**:



- miratimit të akteve përkatëse sipas legjislacionit të posaçëm për trashëgiminë kulturore;
- pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Tiranë.

3.14 Për stacionin “Fari 1348”:

- pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Tiranë.

4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për zbatimin e këtij vendimi.

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**

**EDI RAMA**



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

**BELINDA BALLUKU**



ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

**LEDIA TOTA**

